



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr.225, Datë 26.10.2018

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË OST SHA PËR DISA NDRYSHIME NË "RREGULLOREN PËR PROCEDURAT E BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETET E SHPËRNDARJES DHE TË TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN DHE SHITJEN E ENEGJISË ELEKTRIKE PËR TË SIGURUAR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË SHËRBIMIT PUBLIK.

Në mbështetje të nenit 16, nenit 19, gërma "I" dhe nenit 56, gërma "F", të Ligjit Nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar; VKM nr. 244, dt 30.03.2016 "Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike" i ndryshuar, dhe "Rregullave të tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike", miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.214, dt 28.12.2017, nenit 19, pika f) dhe nenet 26 të "Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s", miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 26.10.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e hartuar nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi shqyrtimin e kërkesës së OST sha, për disa ndryshime në "Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik",

Konstatoi se:

- OST sha me shkresën nr. 2167/4 Prot., datë 08.10.2018, ka kërkuar nga ERE disa ndryshime në "Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik".
- OST sh.a. me shkresën nr. 2167/4 Prot., datë 09.10.2018, ka vijuar korrespondencën lidhur me këto ndryshime, referuar edhe shkresës së Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë me nr. 28 Prot, datë 26.09.2018, nëpërmjet së cilës ka kërkuar rishikimin e Vendimit e Bordit të ERE nr. 103, datë 23.06.2016, i ndryshuar, i cili ka miratuar "Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në

rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”.

- Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë AEES, nuk legjitimohet si palë propozuese për të kërkuar ndryshime në *“Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”*, ku palë janë OST sha dhe OSHEE sh.a, bazuar në neni 62 dhe 69 të Ligjit Nr. Ligjit Nr. 43/2015, *“Për Sektorin e Energjisë Elektrike”*, i ndryshuar
- Kërkesa për interpretim të dispozitave dhe ndryshime në këtë rregullore është shtruar edhe më heret nga OST sha me shkresat nr. 6393/1, dt 11.12.2017; nr. 2167 Prot., datë 11.04.2018 dhe nr. 2167/3 Prot., datë 08.05.2018, por ERE nëpërmjet shkresave nr 747/2, dt 21.12.2017; nr. 259 Prot., datë 13.03.2018 dhe nr. 259/2 Prot., datë 18.04.2018, i ka kërkuar OST sha të paraqesë për shqyrtim propozime konkrete të kërkesës për ndryshime.
- OST sha kërkon që për analogji edhe me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, të mund të konsiderohet i vlefshëm procesi me një ofertë të vlefshme.
- Kjo rregullore paraqet formë të thjeshtëzuar të procedurave të prokurimit publik. Rregullorja është draftuar në konsulencë me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë ENC. Gjithashtu kjo rregullore paraqet procedura edhe për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve nga operatori i shpërndarjes së energjisë OSHEE sha (sot OSSH sha), kështu marrja e opinionit të OSSH sha dhe Sekretariati të Komunitetit të Energjisë, ENC në lidhje me ndryshimet e kërkuara nga OST sha konsiderohet e nevojshme në këtë proces.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST sha mbi disa ndryshime në *“Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”*, si më poshtë:

Në nenin 15 të “Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik” propozohet të shtohet:

- Në rastin e përsëritjes së procesit, procesi të zhvillohet i njëjtë me atë fillestar dhe procedura të përsëritet aq herë sa është e nevojshme për arritjen e qëllimit, blerjes së sasisë së nevojshme të energjisë.

- Procesi mund të konsiderohet i vlefshëm dhe me një ofertë të vlefshme.
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë OST sha, OSHEE sh.a, AAES dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, për Vendimin e Bordit të ERE.

KRYETARI

PETRIT AHMETI